



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT-LIGJ

Nr. _____, datë ____/____/2018

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10416, DATË 07.04.2011 “PËR
MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10416, datë 07.04.2011, “Për Materialin Mbjellës dhe Shumues Bimor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pika 8 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 11, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet si vijon:

“1. Furnizuesi, në cilësinë e prodhuesit, kryen veprimtarinë e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.”.

2. Pika 5, ndryshohet si vijon:

“5. Prodhimi i kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor bëhet nga furnizues publikë ose privatë, pas njoftimit paraprak të ministrisë dhe që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie prodhimin e kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Procedurat e njoftimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 3

Në nenin 23, pika 1, ndryshon si vijon:

“1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor importohet vetëm nga subjekte, të cilat janë pajisur paraprakisht me autorizim nga ministri dhe që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Autorizimi lëshohet për çdo sasi të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që importohet”.

Neni 4

Në nenin 24, pika 3 ndryshohet si vijon:

“3. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, inspektori verifikon nëse furnizuesi është i autorizuar për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve që ai importon”.

Neni 5

Në nenin 29, pika 4, shkronja “a”, ndryshohet si vijon:

“ a) person fizik ose juridik i autorizuar.”.

Neni 6

Në nenin 43, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a”, ndryshohet si vijon:

“a) ndalon kryerjen e veprimtarive për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor nga një person që nuk është i autorizuar”.

2. Shkronja “c”, ndryshohet si vijon:

“c) propozon për ndalimin përkohësisht të zbatimit të veprimtarive të furnizuesit nëse furnizuesi ka shkelur kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ose propozon ndalimin e zbatimit të veprimtarisë së furnizuesit për rastet kur detyrat e lëna nga ai nuk janë zbatuar për më shumë se dy herë”.

Neni 7

Neni 44 ndryshon dhe riformulohet:

Analizat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor

1. Analizat laboratorike, zyrtare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhen në laboratorë të miratuar dhe/ose në laborator të akredituar i miratuar si laboratorë reference nga ministri përgjegjës për bujqësinë;
2. Laboratori i referencës shërben si laborator për vlerësimin e cilësisë dhe besueshmërinë e analizave të kryera nga laboratorët e miratuar, si dhe jep vlerësimin përfundimtar të testeve të kryera në këto laboratorë;
3. Laboratori i referencës kryen analizat e mostrave, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimi të treguesve cilësorë për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
4. Laboratori i referencës duhet të akreditohet nga një institucioni i pavarur jo më vonë se dy vjet nga miratimi nga ministri përgjegjës për bujqësinë si laborator reference;
5. Kriteret, që duhet të plotësojnë laboratorët e miratuar dhe laboratori i referencës dhe analizat që do të kryejnë këta laboratorë përcaktohen me urdhër ministrit;
6. Procedura që ndiqen për marrjen e mostrave dhe lëvizja e tyre për kryerjen e analizave në laborator, përcaktohen me udhëzim të ministrit;
7. Lista e analizave që kryen laboratori i referencës botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 8

Neni 58 ndryshon si më poshtë:

Në pikës 1 hiqet përcaktimi për nenin 44 pika 4.

Në pikën 2, shtohet, neni 44 pika 5 dhe 6.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI